



**BASHKIA E TIRANËS**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE

**SHPALLJE PËR  
LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL  
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE  
(Specialist)**

**Lloji i diplomës “Shkenca Inxhinierike” niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II ,III,IV dhe VII të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore, Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në Shërbimin Civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- 1 (një) Specialist në Sektorin e GIS Kadastrës Urbane, në Drejtorinë e GIS Kadastrës në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë e Tiranës, kategoria e pagës III-b;

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin, nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE: **07 Nëntor 2016**

Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: **14 Nëntor 2016**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:**

- a. Të kryejë rivetime të ndryshme si sheshe, rrugë, lulishte, si dhe azhornime të linjave elektrike, kanalizimeve të ujrave të bardha, pusetave etj për vijën e verdhë të qytetit të Tiranës.
- b. Të punojë për, përpunimin e materialeve hartografike të ardhura nga ZVRPP-ja Tiranë, në lidhje me zgjatimin e bulevardit kryesor të qytetit të Tiranës;
- c. Të zhvillojë të dhënat dhe shërbimet të Gis-it, si dhe mbledhjen, migrimin, importimin dhe riformatimin e të dhënave, krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave aktuale duke përdorur programe Gis.
- d. Të sigurojë përgatitjen (në bashkëpunim me të tretë) dhe botimin e manualeve metodologjike për planifikimin e territorit si dhe të programeve të trajnimit për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit;
- e. Të bashkëpunojë për kryerjen e studimeve dhe vlerësimeve për zhvillimet në territor për vijën e verdhë të qytetit të Tiranës dhe ofrimit të informacionit dhe statistikave strukturave përkatëse, palëve të interesuara dhe publikut.

# 1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

## 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë (IV-a / III-b);
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Inxhinierike

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Tiranës brenda **datës 07 Nëntor 2016**.

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **11 Nëntor 2016**, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

## 1.3 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015 për Vetëqëverisjen Vendore;
- b- Ligji nr 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- d- Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit“
- e- Ligji Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit“ i ndryshuar

f- Ligji Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

### **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

## **2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe stendat e informimit të publikut duke filluar nga data **22 Nëntor 2016**.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

a- Të jetë shtetas shqiptar;

b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

a. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Inxhinierike

### **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Tiranës brenda datës **14 Nëntor 2016**.

### **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **22 Nëntor 2016**, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

### **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4**

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

### **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stendat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në Shërbim Civil në kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data **22 Nëntor 2016**.